

Fjala e kryetarit të Akademisë, akademik Mehmet Kraja, në mbledhjen komemorative për Luan Mulliqin

Të nderuar kolegë, akademikë, familjarë të Luan Mulliqit, artdashës dhe të tjerë të pranishëm.

I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, të nderuar ministra,

Së pari ju ftoj që me një minutë heshtje të nderojmë figurën dhe personalitetin e kolegut tonë, anëtarit korrespondent, sekretarit shkencor të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, skulptorit Luan Mulliqi.

I përjetshëm qoftë kujtimi për të ndjerin Luan Mulliqi!

Miq të nderuar! Tani më lejoni që të sjell në vëmendjen tuaj disa veçori dhe arritje në punën krijuese të Luan Mulliqit. Ne të gjithë e kemi vlerësuar, por mbi të gjitha e ka vlerësuar komuniteti artistik, për punën e bërë, për ekspozitat, për prezantimet në evenimente të ndryshme artistike, në paraqitje individuale ose të përbashkëta në Kosovë dhe jashtë saj. Por më duket se një gjë nuk e kemi thënë tamam: se Luan Mulliqi i takon atij numri të vogël krijuesish të Kosovës, të cilët zhvilluan dhe kultivuan kulturën figurative të ne, veçmas në Prishtinë, kulturën e skulpturës dhe të monumentit, të shtatores dhe të përmendores. Kjo kulturë që në krye të herës kërkonte një dalje nga realizmi dhe synonte kërkimin e identitetit, duke kërkuar stil dhe ide të reja, por njëkohësisht duke i dhënë formë meditative dhe racionale.

Së këndejmi, biografia e Luan Mulliqit është e pasur me pjesëmarrje në një sërë evenimentesh artistike. Ai ka marrë pjesë në shumë simpoziume të skulpturës dhe koloni artistike me karakter ndërkombëtar. Ishte aktiv në jetën kulturore dhe artistike të Kosovës, qoftë me shkrime për artin dhe trashëgiminë, apo për jetën kulturore në përgjithësi. Gjithashtu bëri dy monografi për artin pamor në Kosovë. Më anë tjetër, Luan Mulliqi hapi një sërë ekspozitash personale nga Timishoara deri në Çikago, nga Nju-Jorku deri në Vjenë e Prishtinë, mori çmime në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, teksa veprat e tij pasuruan koleksione private të personaliteteve të njohura, koleksione të disa galerive dhe muzeve të ndryshëm.

Ikja në amshim e krijuesit nuk e ndal rrugëtimin e veprës së tij. Ajo vazhdon të bëjë jetën e saj, në rastin e Luan Mulliqit, edhe përmes monumenteve dhe përmendoreve nëpër sheshe dhe parqe, duke sjellë në vëmendje jo vetëm respektin për figurat e ndritura, por edhe respektin për autorin e tyre.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Ngushëllime familjes dhe miqve!